



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.129

Datë 19.09.2022

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmimeve të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 29.09.2022, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**Njoftim**

Mbi shpalljen e thirrjes për aplikim në zbatim të VKM 348, datë 29.04.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit"

Në zbatim të Programit të Qeverisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për aplikimin në Programet e Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në Buletinin e Njoftimeve Publike, Nr.50, datë 19.04.2022, ka njoftuar hapjen e aplikimeve për programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2022, me fondin prej 550 milion lekë, të akorduar nga Buxheti i shtetit.

Në zbatim të VKM 348, datë 29.04.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit", Kreu III, "Rregullat dhe procedurat për përfitimin e programit të vetëpunësimit" pika 1, AKPA, shpall thirrjen ku ftohen të gjithë punëkërkuarit e papunë e regjistruar në Zyrat Vendore të Punësimit, që kanë një ide biznesi, të marrin pjesë në këtë Program.

Afati i aplikimit në programin e Vetëpunësimit për të gjithë punëkërkesit e papunë të regjistruar në Zyrat Vendore të Punësimi është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Aplikuesi duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Është punëkërkes i papunë i regjistruar në strukturën vendore të punësimi;
2. Ka një ide biznesi e cila nuk është në kundërshtim me kriteret e konkurrueshmërisë, të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Punës, dhe që deklarohet në bazë të një formulari të posaçëm.

Aplikimi do të bëhet në portalin puna.gov.al, në adresën:

<https://puna.gov.al/profili/punekerkes/programVetepunesimi>